**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA E NOTERISË TIRANE**

**Nr..1788...REP.**
**Nr.....355/4...KOL.**

Take Regjistr

## *KONTRATE SHITJE*

## *TE KUOTAVE TE KAPITALIT*

Në Tiranë, sot më datë 27/03/ 2004, ditën e shtunë përpara meje noteres Rulo SAKO, Notere pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqitën personalisht palët e mëposhtme :

***SHITËSI :*** **Z. ALFRED GROSI,** i biri Miços dhe i Vitos i datëlindjes 17/ 09/ 1953, lindur në Korçë, shtetas Shqiptar, banues në adresën : Ruga "Komuna e Parisit", Pallatet ABC, Construcion, Nr. 11/B, Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me **Nr. 0278527**.

***BLERËSI :*** **Z. ADRIAN DULAKU,** shtetas shqiptar, lindur me 05. 02. 1960, ne Tirane, Shqiperi, banues ne adresen : Rruga "Pjeter Bogdani" Nr. 24/4, Tirane, mbajtes i pasaportes me **Nr. 0362863.**

**Z. ARAN DULAKU,** shtetas shqiptar, lindur me 30. 05. 1965, ne Tirane, Shqiperi, banues ne adresen : Rruga "Pjeter Bogdani" Nr.24/4, Tirane, mbajtes i pasaportes me **Nr. Z.0031648Z.**

**Z. GENC DULAKU,** shtetas shqiptar, lindur me 30. 05. 1967, ne Tirane, Shqipëri, banues ne adresen : Rruga "Pjeter Bogdani" Nr.24/4, Tirane, mbajtes i pasaportes me **Nr. 0368241.**

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë noteri konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin.

Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, bien dakord të hartojnë këtë KONTRAT SHITJEJE TË KUOTAVE TE KAPITALIT, sipas kushteve dhe kritereve të mëposhtëme :

### KUSHTE PARAPRAKE

Shoqëria "ALBABETON" Shpk, është rregjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë me Nr 19971, datë 27 09. 1996. me Seli të saj në adresën : Kamëz, Tiranë.

Me anë të Vendimit Nr. 15971/3 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, është bërë regjistrimi i Kontratës së Shitjeve të Pjesëve të Kapitalit Nr. Rep. 4387, dhe Nr. Kol. 320, datë 16, 09. 2003, është bërë blerja e 100 % të pjesëve të kapitalit të të Shoqërisë "Albabeton" Shpk, si dhe janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin në Regjistrin Tregtar shqiptar të kësaj Kontrate, ku si Ortak i vetëm i saj tashmë ëstëh Z. Alfret Vito Grosi i cili zotëron 100% (njëqiend përqind) të kuotave të kësaj shoqërie në kapitalin e saj.

Ortaku i vetëm i shoqërisë Z. Alfred Grosi për arsye objektive kërkon të largohet nga shoqëria dhe është plotësisht dakort që t'i shesë kuotat e tij personit të meposhtem :

## OBJEKTI

Me anë të kësaj kontrate, pala Shitëse Z. Alfred Vito Grosi i cili zotëron 100 % (Njëqind përqind) të kuotave të Shoqërisë "Albabeton" Shpk, me dëshirën e tij dhe kërkesën e bleresave, i shet dhe i transferon palës Blerëse, Z. Adrian Dulaku, Z. Artan Dulaku dhe Z. Genc Dulaku, të cilët pranojnë dhe blejnë 100 % (Njëqind përqind) të pjesëve të kuotave në kapitalin e Shoqërisë "Albabeton" Shpk, pa asnjë pretendim të tashëm apo të ardhshëm mbi to, në kuotat e mëposhtëme :

- Adrian Dulaku, paranon të blejë 30 % (Tridhjetë përqind) të kuotave kapitalit një vlerë prej 3000 USD (Tremijë Dollarë Amerikan), ku vlera nominale e një kuote është 100 USD (Njëqind Dollarë Amerikan), duke u bere ortak me 30 %(Tridhjetë përqind) të kapital në Shoqërinë "Albabeton" Shpk.
- Artan Dulaku, paranon të blejë 40 % (Dyzet përqind) të kuotave kapitalit një vlerë prej 4000 USD (Katër mijë) ku vlera nominale e një kuote është 100 USD (Njëqind Dollarë Amerikan), duke u bere ortak me 40 % të kapital në Shoqërinë "Albabeton" Shpk.
- Genc Dulaku, paranon të blejë 30 % (Tridhjet përqind) të kuotave kapitalit një vlerë prej 3000 USD (Tremijë Dollarë Amerikan), ku vlera nominale e një kuote është 100 USD(Njëqind Dollarë Amerikan), duke u bere ortak me 30 % (Tridhjetë përrqind) të kapital në Shoqërinë "Albabeton" Shpk.

Pra që nga ky moment Ortakë të Shoqërisë "Albabeton" Sh.p.k do të jenë Z. Adrian Dulaku, me 30 % të kapitalit, Z. Artan Dulaku me 40 % të kapitalit dhe Z. Genc Dulaku 30 % të kapitalit.

## ÇMIMI I SHITJES DHE MËNYRA E PAGIMIT

Pjesët prej 100 % (njëqind përqind) të kapitalit të Shoqërisë të zotëruara prej Shitësit, shiten (transferohen) tek Blerësat të cilët pranojnë t'i blejnë kundrejt çmimit në total prej 10,000 USD, (Dhjetë mijë Dollarë Amerikan), vlerë për të cilën Blerësat nuk ka asnjë pretendim.

Palët kontraktore në marrëveshje të përbashkët kanë rënë dakort që çmimi i shitjes prej 10,000 USD, (Dhjetë mijë Dollarë Amerikan), të paguhet sipas përqindjes së kuotave të sejcilit si më poshtë vijon :

- Adrian Dulaku, paranon të likujdojë çmimin e shitjes në shumën prej 3000 USD (Tremijë Dollarë Amerikan), për 30 % (Tridhjetë përqind), të kuotave kapitalit në Shoqërinë "Albabeton" shpk të blerë prej tij, çmim i cili është likujduar totalisht, jashtë zyrës së noterisë.
- Artan Dulaku, paranon të likujdojë çmimin e shitjes në shumën prej 4000 USD (Katër mijë), për 40 % (Dyzet përqind), të kuotave kapitalit në Shoqërinë "Albabeton" shpk të blerë prej tij, çmim i cili është likujduar totalisht, jashtë zyrës së noterisë.
- Genc Dulaku, paranon të likujdojë çmimin e shitjes në shumën prej 3000 USD (Tremijë Dollarë Amerikan), për 30 % (Tridhjetë përqind) të kuotave kapitalit në Shoqërinë "Albabeton" shpk të blerë prej tij, çmim i cili është likujduar totalisht, jashtë zyrës së noterisë.

## GARANCITË

Bleresat garantojnë Shitesin se pranojnë dispozitat e parashikuara në statutin e shoqerise "Albabeton" Shpk dhe garantojnë respektimin e plote te tyre.

Në momentin që Shitësit arkëton çmimin e sipërpërmendur, ai humbet çdo të drejtë pronësie, për drejtimin e shoqërisë dhe çdo të drejtë tjetër që rrjedh nga zotërimi i pjesëve të kapitalit të Shoqërise dhe Blerësi bëhet pronar i vetëm i ligjshem i të gjithë kapitalit të Shoqërisë.

Blerësat garantojnë Shitësin se janë në dijeni të Kontratës së Shitjes me Nr. Rep. 4387, dhe Nr.Kol. 320, datë 16. 09. 2003, Kontratës së Kredisë Bankare, me Nr. Rep. 2462, dhe Nr. Kol. 592, datë 22. 10. 2003, si dhe të Marrëveshjes për lënie peng me Nr. Rep. 2462, dhe Nr. Kol. 598, datë 22. 10. 2003, dhe me nënshkrimin e kësaj kontratës Blerësat do të marin përsipër të drejtat dhe detyrimet e Shitësit të sanksionuara në kontratat e mësipërme.

**BAZA LIGJORE**

Kjo Kontratë do te interpretohet dhe zbatohet ne perputhje me dispozitat e Kodit Civil te Republikes se Shqiperise dhe te ligjit nr. 7638 date 19.12.1992 "Mbi shoqerite tregetare „ dhe Ligjit Nr. 7667, datë 28. 01. 1993 Për regjistrin tregtar.

Kjo kontratë do të detyrojë palët dhe do të jetë e vlerfshme midis tyre, ashtu edhe për trashëgimtarët e tyre.

Kjo Kontratë hartohet ne 7 (shtatë) kopje, nje kopje per zyren e regjistrimit te shoqerive tregtare, nje kopje për tu depozituar tek noteri dhe nje kopje per secilen nga palet.

Kjo Kontratë pasi u lexua ne prani time dhe u gjet në perputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë nënshkruhet rregullisht prej palëve në praninë time dhe unë Noterja i vërtetoj kete Kontratë sipas ligjit.

***PALËT KONTRAKTORE***

***SHITËSI***

Z. Alfred GROSI

***BLERËSI***

Z. Adrian DULAKU

Z. Artan DULAKU

Z. Genc DULAKU

**NOTERI**

RUKO SAKO
TIRANE